




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Pranuar - Priljeano Më/Dana		13.12.2017 vit/pod.	
Nr. i organit Org. broj	Numri i Broj	Shënjë Prilog	Vlera Vrednosit
02	035/02	1002	

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/ 491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 2 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vitisë nr 01-016/775 të datës 28.07.2017 për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të klubeve futbollistike që garojnë në Superligë dhe në Ligën e parë ,Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 7.138€ KLUBIT TË FUTBOLLIT “VLLAZNIA “ NGA POZHERANI

#### I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **7138€** me shkronja (shtatmijë e njëqind e tridhjet e tetë euro), Klubit të Futbollit “Vllaznia ” nga Pozherani në emër të mbështetjes financiare të këtij klubi për zhvillimin e garave në Superligë të Republikës së Kosovës.

#### II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 fondi burimor 21 , kategoria ekonomike subvencione dhe transfere ,programi buxhetor Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë .

Obligohet drejtori i KF “Vllaznia” nga Pozherani që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të KF “Vllaznia” nga Pozherani.

#### III.


Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

#### IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti



Viti, më 12.12.2017

Vendimi u dorëzohet:

1. KF “Vllaznia” Pozheran
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi